



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr. 221/5 prot.

Tiranë, më 14.05.2026

VENDIM

Nr. 16, datë 14.05.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 221 Prot., datë 20.01.2026, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Qarku Shkodër” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 24.11.2025, depozituar pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Qarku Shkodër, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/ dokumentacioni, në lidhje me:

- *Listën e plotë të nipteve për subjektet që ju keni bllokuar misrin në doganë nga 1 shtatori 2025 deri ne 22 nëntor 2025.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 3041/1 Prot., datë 15.12.2025, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion, duke sqaruar se: “...Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 99/2024, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Referuar këtij ligji, veprimtaria inspektuese bazohet, ndër të tjera, në parimin e konfidencialitetit, të parashikuar shprehimisht në nenin përkatës të ligjit të

inspektimit dhe, konkretisht Neni 10 “Parimi i informimit të publikut dhe mbrojtjes së konfidencialitetit”, sipas të cilit informacionet dhe të dhënat e siguruara gjatë procesit të inspektimit nuk mund të bëhen publike apo t’u vihen në dispozicion palëve të treta.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeht ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 221/1 Prot., datë 26.01.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 02.02.2026.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 437/1 Prot., datë 04.02.2026, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: *“Në analizë të kërkesës për rivlerësimin e dhënies së informacionit të kërkuar, Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga DRAKU Shkodër është i drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Konkretisht, informacioni i kërkuar lidhet drejtëpërdrejtë me veprimtarinë inspektuese të ushtruar nga DRAKU Shkodër, si dhe me masat administrative të marra ndaj subjekteve tregtare të caktuara, në kuadër të ushtrimit të funksioneve ligjore të institucionit. Referuar nenit 10 të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, parashikohet shprehimisht se parimi i informimit të publikut, zbatohet duke respektuar njëkohësisht detyrimin për mbrojtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe të dhënave të siguruara gjatë procesit të inspektimit. Në këtë kuptim, informacioni dhe dokumentacioni i përfutur gjatë inspektimeve, nuk mund të bëhet publik apo t’u vihet në dispozicion palëve të treta, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ligji. Lista e plotë e subjekteve tregtare dhe numri unik i identifikimit të tyre (NUIS), ndaj të cilëve janë marrë masa administrative, përbën informacion që lidhet me veprimtarinë tregtare dhe statusin ligjor të subjekteve, si dhe përmban të dhëna që gëzojnë mbrojtje ligjore në aspektin e konfidencialitetit tregtar dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Dhënia e këtij informacioni në formë të plotë, do të cënonte interesat e ligjshme të subjekteve të treta dhe do të binte në kundërshtim me kufizimet ligjore të parashikuara. Megjithatë, në zbatim të proporcionalitetit dhe të transparencës së kufizuar, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vlerëson se maksimalisht, mund të vihet në dispozicion informacion i përgjithësuar dhe i anonimizuar, konkretisht*

vetëm përmes inicialeve të subjekteve tregtare, pa identifikues apo elemente të tjerë që do të mundësonin identifikimin e tyre të drejtëpërdrejtë. Në këto kushte, dhënia e informacionit të kërkuar në formën e plotë nuk është e mundur, ndërsa ofrimi i tij vetëm në formë të kufizuar dhe të anonimizuar përbën kufirin maksimal të lejuar nga legjislacioni në fuqi. Për sa më sipër, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vlerëson se, refuzimi për dhënien e informacionit të kërkuar në formën e pretenduar, është i bazuar në ligj dhe i justifikuar, e për rrjedhojë, nuk ekzistojnë kushte për rishqyrtimin apo ndryshimin e përgjigjes së dhënë nga DRAKU Shkodër.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 16.02.2026 me praninë e përfaqësueses së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe ankuesit, ndërsa Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Qarku Shkodër, edhe pse kishte dijeni nuk u paraqit në seance.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën fillestare, si dhe vijimin e saj. Ndërkohë, përfaqësuesja e Autoritetit Publik pasi rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur në aktet shkresore të sipërcituara, ju la kohë në dispozicion për t’u informuar lidhur me fazën aktuale të inspektimeve mbi ngarkesat e misrit me origjinë nga Serbia, bllokuar nga dogana PIK Hani i Hotit dhe nëse është bërë testi i interesit publik gjatë shqyrtimit të kërkesës për informacion.

Me emailin datë 18.02.2026, Autoriteti Publik sqaroi se: “...Faza aktuale në të cilën ndodhen subjektet e Qarkut Shkodër mbi ngarkesat e misrit me origjinë nga Serbia, bllokuar nga dogana PIK Hani i Hotit, është ende në proces. Konkretisht, për njërin nga subjektet, faza ndodhet në pritje të zhvillimit të procedurës së asgjësimit të produktit, ndërsa për subjektet e tjerë, faza ndodhet në pritje të përgjigjes së analizave për mostrat e marra. Sa i përket testit të interesit publik, për rastin konkret nuk është zhvilluar.”

Me emailin e administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 221/4 Prot., datë 13.03.2026 ankuesi ka vijuar ankimin duke kërkuar marrjen e një vendimi lidhur me ankesën objekt shqyrtimi.

Ndodhur në këto kushte, për nevoja të mëtejshme të procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit me emailin datë 12.03.2026, kërkoi nga Inspektorati i Përgjithshëm, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Qarku Shkodër, nëse kundër vendimit të ndërmjetëm të masës urgjente, subjekti i interesuar ka

ushtruar të drejtën e ankimit të vecantë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit. Në vijim, Inspektorati i Përgjithshëm me emailin datë 17.03.2026 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se, *autoriteti përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurës është DRAKU Shkodër, i cili mund t'ju vendosë në dispozicion të gjithë informacionin e detajuar*. Ndërkohë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me emailin datë 24.03.2026 ka bërë me dije se, *subjekti nuk ka ushtruar ankim për vendimin e ndërmjetëm të masës urgjente të datës 18.12.2025*.

Në vijim, Autoriteti Publik nëpërmjet emailit 17.04.2026 ka dhënë sqarime mbi fazën aktuale të hetimit, konkretisht: *“Për njërin prej subjekteve, është marrë rezultati i analizave të mostrës, nga ku ka rezultuar konform (pra, negative për 'Aflatoksinë'); Për njërin prej subjekteve, është marrë rezultati i analizave të mostrave, nga ku kanë rezultuar jokonform (pra, pozitive për 'Aflatoksinë'). Subjekti në fjalë ka kërkuar rianalizim të produktit dhe në përfundim të këtij procesi, është konfirmuar rezultati i parë, pra, sërish mostrat kanë rezultuar jokonform (pozitive për 'Aflatoksinë'). Në lidhje me këtë rast, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka referuar një kallëzim penal pranë organeve hetimore. Në këto kushte, Ju vendosim në vëmendje kufizimet që ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" (i ndeyshtuar), parashikon në Kreun IV "Kufizimi i së drejtës për informim", neni 17, pika 2, gërma 'b)', e tij, se: "E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale; [...]"; Për njërin prej subjekteve, faza ndodhet në pritje të zhvillimit të procedurës së asgjësimit të produktit (ende në proces).”*

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*. Në kuptim të këtij parashikimi, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj*

ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”

Sqarojmë se LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar*. Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, që përfshin ato informacione për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI, detyrim të cilin Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur.

Në argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik se, *Lista e plotë e subjekteve tregtare dhe numri unik i identifikimit të tyre (NUIS), ndaj të cilëve janë marrë masa administrative, përbën informacion që lidhet me veprimtarinë tregtare dhe statusin ligjor të subjekteve, si dhe përmban të dhëna që gëzojnë mbrojtje ligjore në aspektin e konfidencialitetit tregtar dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi*, Komisioneri vlerëson se, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi informacioni i kërkuar lidhet me sigurinë ushqimore dhe si rrjedhojë paraqet interes të lartë publik. Konstatohet se, Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, propocionale, si dhe dëmin që mund t’u shkaktojë bizneseve/kompanive si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar. Po ashtu, bazuar në pikën 23 të nenit 5, të ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, *“Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror*. Në këtë kuadër, emrat e subjekteve të regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjislacionit përkatës tregtar, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj.

Ndërkohë, në nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, është përcaktuar qartë kufiri i sekretit tregtar, i cili përfshin vetëm informacionin e brendshëm. Megjithatë, në pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji parashikohet se: *“2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkëljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”*.

Lidhur me subjektin ndaj të cilit është dhënë vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente për asgjësimin e produktit, Komisioneri vlerëson se, për aq kohë sa Autoriteti Publik

konfirmon se subjekti nuk e ka ankimuar vendimin e ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente për asgjësimin e produktit, informacioni/dokumentacioni i kërkuar për këtë subjekt përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”* dhe duhet vënë në dispozicion të ankuesit.

Sa i përket subjektit ndaj të cilit rezultati i analizave të mostrës, ka rezultuar konform (pra, negative për “Aflatoksinë”), Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik nuk ka referuar asnjë dispozitë ligjore që mund të bëhet pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duke nënvizuar faktin që ndaj këtij subjekti nuk është konstatuar “Aflatoksinë” në mostrat e marra.

Ndërkohë, lidhur me subjektin ndaj të cilit në rezultatin e analizave të mostrave, ka rezultuar jokonform (pra, pozitive për “Aflatoksinë”) dhe pretendimin e Autoritetit Publik se për aq kohë sa është referuar një kallëzim penal pranë organeve hetimore rrjedhimisht *“E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale; [...]”*, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Referuar gjithë dispozitave të sipërcituara, fakti që, ndaj këtij subjekti është referuar një kallëzim penal, nuk e pengon Autoritetin Publik të informojë ankuesin mbi emrin/NUIS e këtij subjekti, për aq kohë sa ky informacion nuk cënon procesin e nisur pranë organeve kompetente. Gjithashtu, autoriteti publik nuk ka dhënë argumente se si dhënia e informacionit të kërkuar cënon interesin e mësipërm.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, Komisioneri vlerëson se ekzistenca e informacionit/dokumentacionit, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjithashtu, kërkuesi/ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Në përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo

shtetëror, që ushtron funksione publike. Bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 221 Prot., datë 20.01.2026, (vijuar me nr. 221/4 Prot., datë 13.03.2026) të z. kundër Autoritetit Publik “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Qarku Shkodër”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 24.11.2025, konkretisht: (“Niptin e subjektit ndaj të cilit është dhënë vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente për asgjësimin e produktit: Niptin e subjektit ndaj të cilit ka rezultuar konform duke nënvizuar faktin që ndaj këtij subjekti nuk është konstatuar “Aflatoksinë” në mostrat e marra; Niptin e subjektit ndaj të cilit ka rezultuar jokonform), brenda datës 21.05.2026.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 14.05.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi